



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtruesi i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 75-të, të mbajtur më 14.10.2022, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Procedura sipas lëndës nr. 12 - 4439/1, datë 02.11.2021, e formuar sipas denoncimit me pretendime ndaj një zyrtari komunal për marrje ryshfeti nga qytetarët në procedurat e privatizimit dhe shpronësimit në -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për faktin se lënda në fjalë trajtohet nga një autoritet tjetër kompetent për të vepruar nga fusha para së cilës procedura pas denoncimit është ende në vazhdim. Lënda me numër 12 - 4439/1 të datës 02.11.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga ana e një parashtruesi të panjohur është dorëzuar denoncim me numër 12 - 4439/1 i datës 02.11.2021, pas së cilës në KSHPK është formuar lënda me pretendime kundër zyrtarit komunal ----- nga -----, për kërkesën për ryshfet nga qytetarët në procedurën e privatizimit dhe shpronësimit të regjistruar në Drejtorinë Rajonale për procedurën administrative të shkallës së parë në ----- – Administrata për çështjet juridike pronësore.

Për konstatimin e gjendjes faktike në lidhje me këtë çështje, KSHPK-ja dorëzoi kërkesën përkatëse për veprim kompetent pranë Administratës së Policisë Financiare dhe kërkoi që të njoftohet për rezultatin e veprimit të tyre kompetent për pretendimet në fjalë, si dhe për masat e marra të mundshme prej tyre. Pas kërkesës është marrë informacioni i kërkuar dhe pas inspektimit të të njëjtit është konstatuar se Administrata e Policisë Financiare është duke vepruar në lidhje me raportin e paraqitur dhe duke ndërmarrë veprimet e nevojshme në kuadër të veprimit të tyre kompetent.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se për lëndën në fjalë vepron autoritet tjetër kompetent i cili është kompetent për të vepruar nga fusha dhe para së cilës procedura është ende në vazhdim, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

КОМИСИОН ШТЕТЁРОРЁ  
ПЁР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

Pёrgatiti: J.C.  
Miratoi: N.B., Anёtar i KSHPK-sё

